



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli: Batus Holding Inc. / Reynolds American Inc.

Në datën 15 Shkurt 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Marrëveshje dhe plan bashkimi”. Me anë të kësaj marrëveshje, të nënshkruar me datë 16 Janar 2017, synohet të realizohet kalimi i drejtpërdrejtë i kontrollit të shoqërisë Reynolds American Inc. (“Target”) nga shoqëria Batus Holding Inc. (“Blerësi”).

Ky njoftim bëhet për shkak se Grupi BAT realizon shitje në Shqipëri dhe plotësohen kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Batus Holding Inc.:** është një shoqëri globale dhe aktiviteti kryesor i saj është prodhimi dhe shitja me shumicë e produkteve të duhanit. Shoqëria është pjesë e grupit British American Tobacco p.l.c..
- **Reynolds American Inc.:** është organizuar në formën e grupit të disa shoqërive (*holding*) me aktivitet kryesor prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve me shumicë të duhanit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me neni 10, pika 1, shkronja a, b dhe c, dhe neni 12, pika 1 dhe 2, të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al